

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 11, 13 – 19 Mars 2017

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 rrethe ose 100% (=36/36) e tyre

3 rrethe ose 8% (=3/36) e tyre kanë raportuar me telefon, faks, postë:
HAS, M. MADHE, PEQIN,

33 rrethe ose 92% (=33/36) e tyre kanë raportuar me postë elektronike:

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUJË, KUÇOVË, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, MAT, MIRDITË, PËRMET, POGRADEK, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORE.

Pa raportim brenda afatit, asnjë rreth ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS “ALERT” NË JAVËN 11

	JAVA 11
DIARRE PA GJAK	1.255
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	7.233
INF. RESP. TE POSHTËME	4.331
RASH ME TEMPERATURË	2
VERDHËZA	0
HEMORRAGJI ME TEMPERATURË	0
SUSPEKT MENINGITIS	0
ETHE TË PASHPJEGUESHME	0
Numri i Njësive Raportuese	400
% e Njësive Raportuese	93% (400/427)


Rash me temperaturë

1 rast është raportuar nga rrethi i Fierit dhe 1 rast nga rrethi i Pogradecit. Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe epidemiolog të rretheve rastet nuk janë suspekt fruth apo rubeolë por varicelë.


Duke u nisur nga shpërthimet epidemike të Fruthit që po ndodhin në disa shtete të Europës dhe Ballkanit, në komunikimin me epidemiologët e rretheve është theksuar përforcimi i Survejancës së sindromit “rash makulopapular me temperaturë” nga mjekët Pediatër dhe Infeksionistë.

Infeksione Respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet rënie në javën e 11 krahasuar me javën paraardhëse, java 10.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i “Diarre pa gjak” paraqet rënie në javën 11 krahasuar me javën paraardhëse, java 10.

Trendi i “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 01 – 11 të vitit 2016 dhe të vitit 2017 . Numri i rasteve.




Në javën e 11-të të vitit 2017 vërehet një trend në rënie i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 21% më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës në javën e 11-të të vitit 2017. Numri i rasteve dhe Incidenca (raste/10.000)




Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rretheve në javën 10 dhe 11 të vitit 2017. Incidenca (raste/10.000)



Trendi i “Diarreve pa Gjak” në javët 01 – 11 të vitit 2016 dhe të vitit 2017. Numri i rasteve.

Në javën e 11-të të vitit 2017 vërehet një trend në rënie i numrit të rasteve të “Diarre pa gjak” dhe ky numër është pothuajse i njëjtë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas rretheve në javën 10 dhe javën 11 të vitit 2017. Incidenca (raste/10.000)

Shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Nivelet e Raportimit për javën e 11 sipas rretheve, në përqindje.

